



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
01 Nr. / Br	33 / 20
Nr. i fq. / Br. st	-4-
Data: / Datum	14. 02. 2020
VUSHTRRI - VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
16 janar 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 13:20.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF-së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Refik Maloku, Adnan Lahu dhe Sylejman Mehulli,), Ismet Gashi nga zyra ligjore, Xhavit Mehmeti, zyrtar për integritet evropiane, përfaqësues nga OSBE-ja si dhe nga sekretaria e kuvendit Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu tha se na kanë ardhur edhe disa propozime për t'i futur në pika të ndryshme.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 dhjetor 2019;
2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë;
3. Shqyrtimi i Raportit janar – dhjetor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet;
4. Shqyrtimi i Draft-Kodit komunal të etikës;
5. Shqyrtimi i Draft – Planit të Integritetit 2020 – 2022;
6. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë;
7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta për vitin 2019;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pakompensim, Ministrisë së Punëve të Brendshme-Drejtoria Rajonale e Policisë – Mitrovicë;
9. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës;
10. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për Ajmane Ferati Shatrolli;
11. Shqyrtimi i kërkesës së Shaban Halilit për faljen e pronës për varreza dhe
12. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 dhjetor 2019.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 12 dhjetor 2019.

2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Raportit janar – dhjetor 2019 për të hyrat dhe shpenzimet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – lidhur me raportin, vërejtjet e mia do t'i jap në mbledhjen e kuvendit.

Ai tha se janë disa projekte që nuk janë zhvilluar. Kryetari i komunës është deklaruar publikisht në kuvend se do ta përfundojë projektin e ndërtimit të lapidarit të Batalionit të Parë, të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës.

Ai e pyeti kryetarin e komunës: Pse nuk është zhvilluar projekti për ndërtimin e lapidarit të Batalionit të Parë, të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës në fshatin Gllavatin?

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës- deklaroi se lidhur me këtë pyetje do të përgjigjem me shkrim.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se në kuvend si grup kuvendar do t'i ngrisim shqetësimet.

Zhegrova deklaroi se sipas informacioneve që kemi, një pjesë e madhe e buxhetit është shpenzuar në ditët e fundit të vitit. Po ashtu, kemi informacione se një pjesë e buxhetit është shpenzuar pa përfunduar punët fare. Ai tha se kuvendi është mirë ta formojë një komision sa u përket këtyre mjeteve financiare dhe moskryerjes së punëve, e posaçërisht lidhur me pagesat që janë kryer në ditët e fundit të vitit.

Zhegrova deklaroi se me këtë çështje do të merren edhe organet tjera, pasi që bëhet fjalë për një shumë të madhe financiare (rreth 400 mijë euro) pa përfunduar punimet fare.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Draft-Kodit komunal të etikës.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së- tha se te neni 15 lidhur me fushatën zgjedhore, është mirë të specifikohet e të bëhet për zyrtarë komunalë, pasi që s'ka logjikë që qytetarët t'i nënshtrohen një kodi të tillë. Po ashtu, kemi një përsëritje të këtij neni.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Draft – Planit të Integritetit 2020 – 2022.

Xhavit Mehmeti, kryesues i komisionit- tha se komuna jonë e ka pasur edhe më herët këtë plan, pasi që është agjendë evropiane që të plotësohet ky kusht. Ky plan tanimë është unik në të gjitha komunat, pra është bërë një standard i njëjtë, pasi që kanë qenë disa komuna që e kanë hartuar këtë plan në formë të ndryshme dhe ka pasur laramani.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta për vitin 2019.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pakompensim, Ministrisë së Punëve të Brendshme- Drejtoria Rajonale e Policisë – Mitrovicë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se kur të kemi propozim-vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale është mirë që të na vjen me ortofoto dhe të dihet saktësisht se për cilën pronë është fjala. Po ashtu, është mirë të përmirësohet një gabim teknik te propozim-vendimi dhe të bëhet 301 m², ashtu siç është në fletën poseduese.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës

9. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim– deklaroi se është drafti i parë dhe kanë mundur të rrjedhin disa gabime, por do t'i përmirësojmë. Risi është se në këtë draft është hequr dhënia e bursës me automatizëm, si dhe disa profileve të shkollave profesionale, t'iu japim mbështetje përmes kësaj rregulloreje.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës- theksoi se e përgëzon Drejtorinë për Arsim për idenë, sepse këto ndryshime nuk ndodhin shpejt, por hap pas hapi. Ai tha se vitin e kaluar janë bërë tri politika, ku një familje ka kursyer 30 euro:

- Heqja e pagesës për parashkollor dhe vetëfinancimin që çdo prind e ka bërë prej 10 euro;
- Transportin e nxënësve, ku janë kursyer 10 euro dhe
- Shujtat ditore për nxënës, janë kursyer 10 euro.

Tek shkollat profesionale, ideja është që të rinjtë që shkojnë në këto drejtime t'i mbështesim financiarisht, psh. në drejtimin e zdrukthëtarisë, ky vitin e kaluar është hapur ky drejtim, pasi që komuna jonë është një nga qytetet më të njohura që merret me përpunimin e drurit, tha ai.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

10. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për Ajmane Ferati Shatrolli.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për” dhe një (1) “kundër” rekomandoi që të procedohet në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për shqyrtim të mëtejme.

11. Shqyrtimi i kërkesës së Shaban Halilit për faljen e pronës për varreza.


Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se nuk e dimë a i plotëson kushtet për varreza ajo parcelë. Përndryshe, një akt i këtij qytetari është i mirë dhe duhet të përkrahet.


Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë– tha se e njëjta kërkesë ka arritur edhe në kadastër. Jemi të njoftuar se kjo parcelë gjendet afër varrezave të fshatit, tha Lahu. Kemi biseduar edhe palën, por edhe banorët e fshatit kanë bërë një peticion se pajtohen që ajo parcelë të shfrytëzohet për varreza. Por, Lahu tha se edhe Drejtoria për Urbanizëm duhet ta shqyrtoj këtë kërkesë se a i plotëson kushtet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për shqyrtim të mëtejme.

12. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës


Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF-së